

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. AGRON VAVLA

12/21/2018

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 19.12.2018 për subjektin e rivlerësimit, z. Agron Vavla, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 21.12.2018 vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Agron Vavla, kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjyqësore e kryesuar nga znj. Firdes Shuli, znj. Etleda Çiftja relatore, z. Roland Ilija anëtar, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.